

## **AKTI I THEMELIMIT**

### **Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Shushica**

Në mbështetje të ligjit nr.38, date 05.04.2012 sot më date 30.01.2024 hartohet ky akt themelimi prej anëtarëve të shoqërisë:

1. Ferit Osmani, i datëlindjes 03.02.1959, me nr personal F90203012M, lindur në Shushice, Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
2. Sherif Nurka, i datëlindjes 05.02.1962, me nr personal G20205021P, lindur në Shushice, Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
3. Mevlud Kutreli, i datëlindjes 05.11.1957, me nr personal F71105015U, lindur në Vehcan Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
4. Kadri Avdiu, i datëlindjes 20.11.1960, me nr personal G01120008O, lindur në Shushice, Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
5. Flutur Hamitja, e datëlindjes 19.12.1967, me nr personal G76219005F, lindur në Shushice, Elbasan dhe banuese në Shushice, Elbasan;
6. Fatmir Guraziu, i datëlindjes 11.02.1974, me nr personal H40211011S, lindur në Shushice, Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
7. Sejdin Polisi, i datëlindjes 01.05.1956, me nr personal F60501031O, lindur në Shushice, Elbasan dhe banues në Shushice, Elbasan;
8. Lavdije Osmani i datelindjes 09.05.1985, me nr personal I55509013W, lindur në Shushicë, Elbasan dhe banuese në Shushice, Elbasan.

Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, jo politikë dhe e pavarur.

#### **Neni 1**

##### **Emri dhe selia e shoqërisë**

Emri i shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor do të jetë:

**Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Shushica**, me seli në Shushicë, Elbasan, Shqipëri.

Inicialet e shoqërisë do të jenë SHBB Shushica. Shoqëria mund të hapë degët saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 2**

##### **Objektivat e Shoqërisë**

Shoqëri e bashkëpunimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe në marketing. Kjo shoqëri mund të prodhojë, të manipulojë, të përpunojë, të ruajë, të klasifikojë, të transportojë, të shpërndajë, të tregtojë produktet bujqësore ose blegtorale në gjendjen e tyre natyrale ose të përpunuar më parë.

**Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Shushica** ka objektiva të mëposhtme:

a) prodhimi dhe grumbullimi i produkteve bujqësore, nga fusha, sera, produkteve blegtorale, të freskëta ose të përpunuara, kryesisht nga anëtarët e shoqërisë;

- b) përpunimi, blerja dhe shitja e produkteve të sipërpërmendura prodhuar nga anëtarët e saj;
- c) realizimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të ndryshme si seleksionimi, paketimi, magazinimi dhe transporti i produkteve të sipërpërmendura, duke përfshirë furnizimin me materiale të tjera ndihmëse;
- d) organizimi i transportit të brendshëm dhe të jashtëm të produkteve të shoqërisë, duke zgjeruar rrjetin e grumbullimit të prodhimit gjë e cila është nën përgjegjësinë ose e autorizuar dhe e kontrolluar nga shoqëria;
- e) marketingun e produkteve bujqësore, organizimin e furnizimit dhe shitjes së inpueteve tek anëtarët e shoqërisë, eksportimin e të njëjtave produkteve bujqësore;
- f) vendosjen në dispozicion ose dhënien me qira të pajisjeve teknike dhe logjistike si për shembull: sipërfaqe ftohjeje dhe magazinimi, linja larjeje, seleksionimi etj;
- g) dhënien e një konsulence të përgjithshme ose specifike rreth kultivimit të prodhimeve bujqësore, menaxhimit ekonomik të fermës kryesisht për anëtarë e saj;
- h) të kryejë investime të reja, të administrojë pronësinë e tokës, të linjave teknologjike, mallrat, kreditë dhe kapitalet e tjera financiare të shoqërisë;
- i) të organizojë aktivitetet në përputhje me qëllimin dhe detyrat e Shoqërisë.

### **Neni 3**

#### **Territori**

**Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Shushica** ka zyrën e saj me adresë rruga “Fangu Tanushi”, banesa nr. 44, Njësia Administrative Shushicë, Elbasan, Shqipëri. Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 4**

#### **Afati i veprimtarisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

### **Neni 5**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve**

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve përcaktohen në këtë ligj dhe në statutin e shoqërisë.
2. Anëtarët kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
  - a) Të propozojnë ndryshimin e administratorëve të shoqërisë;
  - b) Të propozojnë ndryshime apo përmirësime të statutit;
  - c) Të kërkojnë dhe të disponojnë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë, kryesisht kur preken interesat e tyre;
  - d) Të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për gjendjen financiare dhe ekonomike të tyre brenda shoqërisë;
  - e) Të informohen, sa herë që depozitojnë kërkesë me shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht, për:
    - i. Llogaritë vjetore financiare;
    - ii. Raportin e veprimtarisë së shoqërisë;
    - iii. Mënyrën dhe procedurat e ndarjes së fitimit;
    - iv. Raporte te ekspertëve kontabël;

- v. Të informohen rregullisht për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë në informacion pikat e rendit të ditës, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarrjen për çështje të caktuara të cilat mund të prekin interesat e tyre.
3. Nëse në statut nuk parashikohet ndryshe, administratori informon me shkrim anëtarin për çështjet e trajtuara në kërkesën e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.
  4. Çështjet, të cilat kanë lidhje me rregullimet statutores, kushtet e regjistrimit apo mënyrën e drejtimit të shoqërisë, si dhe çështje të tjera, të cilat trajtohen në kërkesën e anëtarëve që zotërojnë 10 për qind të kapitalit të shoqërisë, përfshihen për shqyrtim e diskutim në rendin e ditës së mbledhjes më të parë të asamblesë së përgjithshme.
  5. Anëtari kërkues ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit, duke i u drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzimin.

Anëtarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet e parashikuara në ligj e në statut dhe veçanërisht:

- a) Të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose duke ja deleguar dikujt tjetër;
- b) Të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë, duke aplikuar dhe vendimet ekonomike, që do të vendosen;
- c) Të marrin pjesë në veprimtari që përbëjnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit, përveçse kur asambleja e përgjithshme, në rast të një shkakut të justifikueshëm, mund ta përjashtojë nga ky detyrim anëtarin në masën që i takon dhe sipas rrethanave;
- d) Të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të dëmtojë interesat e ligjshëm të saj;
- e) Të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë dhe objektit të saj dhe të mos bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
- f) Të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
- g) Të përmbushin detyrimet e tjera që rrjedhin nga ligji dhe statuti;
- h) Të kontribuojë në proporcion me kuotën në financimin e aktivitetit ekonomik sipas buxheteve të aprovuara.

## **Neni 6**

### **Kapitali i Regjistruar**

**Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Shushica** ka kapitalin e saj i cili përbëhet nga shuma totale e të gjithë pjesëve të kapitalit depozituar nga gjithë anëtarët e shoqërisë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga kontributet në para. Kapitali ka vlerën e 100,000 Lek.

Kapitali është i përbërë nga 8 pjesë, me vlerë nominale 12.500 Lek secila.

Në bazë të kontributeve, pjesët e anëtarëve zotërohen si më poshtë:

1. Ferit Osmani, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;

2. Sherif Nurka, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
3. Mevlud Kutreli, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
4. Kadri Avdiu, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
5. Flutur Hamitja, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
6. Fatmir Guraziu, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
7. Sejdin Polisi, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë;
8. Lavdije Osmani, zotëron një pjesë të kapitalit, me vlerë 12.500 Leke barazvlefshme 12.5% të Kapitalit të Shoqërisë.

#### Neni 7

#### Përfundimi i anëtarësisë

Anëtari mund të largohet nga shoqëria nëpërmjet mënyrave të më poshtme:

- a) Vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;
- b) Kur është i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në ligjin për shoqërit e bashkëpunimit bujqësor
- c) Në rast likuidimi, kur anëtari është person juridik;
- d) Në rast vdekjeje;
- e) Në çdo rast tjetër, sipas përcatimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- f) Në rastin e mospagesës së pjesës që i takon sipas buxhetit të aprovuar.

Në se kjo pagesë vonohet mbi tre muaj, anëtari quhet i larguar dhe kuota e tij i kalon në mënyrë proporcionale anëtarëve të tjerë.

Ky akt themelimi u përpilua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u pa i rregullt u nënshkrua nga të gjithë anëtarët themelues.

#### PERFAQESIA THEMELUESE

1. Ferit Osmani
2. Sherif Nurka
3. Mevlut Kotreli
4. Kadri Avdiu
5. Flutur Hamitja
6. Fatmir Guraziu
7. Sejdin Polisi
8. Lavdije Osmani

*Ferit Osmani*  
*Sherif Nurka*  
*Mevlut Kotreli*  
*Kadri Avdiu*  
*Flutur Hamitja*  
*Fatmir Guraziu*  
*Sejdin Polisi*  
*Lavdije Osmani*